



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3205/ 11 prot.,

Datë 04.02.2026

V E N D I M
Nr. 207/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 113/2026, datë 21.01.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-65818- 10-20-2025, me objekt “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje” për Drejtorinë e Spitalit I’hsan Çabej Lushnje” me fond limit: 3,166,588 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a..
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF me NIPT L42314005A, me adresë: Rruga “At Zef Pllumbi”, Pallati Nr. 16 Devi 2001 Pasuri Nr 39/118-n10 Zona Kadastrale 2679 vol 31, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 21.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 113/2026, ku vendosi:

[.....]

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-65818-10-20- 2025, me objekt “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje” për Drejtorinë e Spitalit I’hsan Çabej Lushnje” me fond limit: 3,166,588 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë)0 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PF në baze të konstatimeve të shprehura në këtë vendim, duke e kualifikuar këtë operatr ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë..” [...]

I.2. Me shkresën nr. 3317/12 prot., datë 27.01.2026, protokolluar me tonën nr. 3205/8 prot., datë 28.01.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 113/2026 datë 21.01.2026 duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 27.01.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1.. Me shkresën nr. 3317/12 prot., datë 27.01.2026, protokolluar me tonën nr. 3205/8 prot., datë 28.01.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 113/2026 datë 21.01.2026 duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 27.01.2026.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar operatorin ekonomik “*Gentian Sadiku*” P.F në përputhje me vendimin e KPP Nr. 113/2026, datë 21.01.2026.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-65818-10-20- 2025, me objekt “*Blerje materiale të buta dhe veshmbathje*” për Drejtorinë e Spitalit I’hsan Çabej Lushnje” me fond limit: 3,166,588 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

